



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 575/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.09.2019 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-18885-04-18-2019, me objekt: “*Shkolla Asim Vokshi-Palester dhe terrene sportive dhe sisteme te jashtme ne gjimnazin "Asim Vokshi"*”, me fond limit 50 319 591 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 24.05.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Tropojë.”

**Ankimues:** “Kevin Konstruksion” sh.p.k  
Rruga “Adem Jashari”, Nd.4, H.10, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tropojë  
Sheshi “Azem Hajdari”, Bajram Curri

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.04.2019 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-18885-04-18-2019, me objekt: “*Shkolla Asim Vokshi-Palester dhe terrene sportive dhe sistemime te jashtme ne gjimnazin "Asim Vokshi"*”, me fond limit 50 319 591 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 24.05.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Tropojë.

II.2. Në datën 18.06.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Kevin Konstruktion” sh.p.k	34.969.929 lekë, skualifikuar
2. “Halili 1” sh.p.k	42.072.833 lekë, skualifikuar
3. “Pepa Group Group” sh.p.k	42.602.248 lekë, skualifikuar
4. “Vllaznimi” sh.p.k	43.666.753 lekë, skualifikuar
5. “Sireta 2F” sh.p.k	44.841.754 lekë, skualifikuar
6. “Nika” sh.p.k	45.295.806 lekë, skualifikuar
7. “Shpresa-AI” sh.p.k	46.729.671 lekë, skualifikuar
8. “4 A-M” sh.p.k	50.269.533 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik ankimes “Kevin Konstruktion” sh.p.k rezulton i skualifikuar nga KVO-ja me argumentin si vijon:

*Në DST është kërkuar dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

*Per kete duhet qe numri mesatar i punonjësve të siguruar të jetë jo më pak se 80 punonjës për periudhën Tetor 2018 – Prill 2019, nga keta, te kete punonjes te kualifikuar me Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trupe çertifikuese e akredituar ne RSH-se, nder te cilet te kete minimalisht 30*

specialista ndertimi, 4 karpentier, 4 hekurkthyes e saldator, 1 hidraulik, 1 elektrikist, 1 mekanik, ku sejcili duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per gjashte muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave.

Në dokumentat e paraqitur ju nuk vertetoni nr për 30 specialista ndertimi, 4 karpentier, 4 hekurkthyes e saldator, 1 hidraulik, 1 elektrikist, 1 mekanik,

Z.N Baçi i punesuar me kontrate pune date 28.12.2018 Ing Ndertimi prane Kevin Konstruktion shpk rezulton dhe ne kompani të tjera i punesuar si me poshte: Fizik REAN 95, me numër NIPT-i J61827043V, per periudhen Tetor 2018 – Prill 2019, kjo nga vertetimi i Drejtoris Rajonale Tatimore Tirane Nr. Nr. T01111816, date 29.5.2019 dhe N. Baçi PF shpk NIPT-i K91721004S, per periudhen tetor-prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Nr. T01111799, date 29.5.2019. Në kompanine BOLENA shpk NIPT-i J87416223M, per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111838, date 29.5.2019. TONI-SECURITY NIPT-i K94010201F per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111832, date 29.5.2019. EUROGJICISESECURITY, NIPT-i K31929010K per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111820, date 29.5.2019. INA, NIPT-i J61814009Ë, K31929010K per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111811, date 29.5.2019 vulosur ne menyre elektronike, nxjerre nga verifikimi elektronik i e-alabania.

Znj.A.Ciko i punesuar me kontrate pune date 28.12.2018 Ing Mekanik Impiante prane Kevin Konstruktion shpk rezulton dhe ne kompani tjera i punesuar si me poshte: TIRANA TEKNOLOGJI, me numër NIPT-i L61312065J, per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtoris Rajonale Tatimore Tirane Nr. Nr. T01111853, date 29.5.2019 - Veprime keto ne kundershkrim me VKM Nr.42, date 16.01.2008 « Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari «i ndyshuar Kreu IV pika 2 e tije «Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit..Për këtë arsye skualifikoheni.

I. Palushi me kontrate pune Manovrator për periudhën Dhjetor – Prill është paguar me pagë poshtë pagës minimale sipas Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë pagë duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 « Kriteret e perjashtimit te kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet « Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptarë..» Për këtë arsye skualifikoheni.

Z.A. Sakaj Manovrator, eshte i punesuar dhe ne kompanine Kevin Konstruktion shpk ne baze te kontrates 20.02.2018 me page 30,000 leke ne muaj sipas verifikimeve ne sistemin oline e-albania paguhet per periudhen Mars-Prill 2019 me pagese 1,181 leke ne kundershkrim me kontraten e punes, nga verifikimi ne, ne baze te vertetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01118287 date 31.5.2019. Pagesa e sigurimeve shoqërore nuk është bërë mbi vlerën 30,000, por mbi vlerën 1,181 leke. Gjithashtu punonjesi duhej te ishte per nje periudhë 6-mujore i punësuar pranë Kevin Konstruktion shpk. Gjithashtu

*punonjësi për të njëjtën periudhë kohe është i punësuar dhe në kompani tjetër Fizik SPIECAPAG Transadriatica, me numer NIPT-i L61920026B , me perfaqesues ligjor Z/Znj. Guillaume, Marcel, Denis Batut sipas vertetimit e-albania Nr. Nr. T01118296 Drejtoria Rajonale DMT 31.5.2019.*

*Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë page duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643,datë20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 «Kriteret e perjashtimit te kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet «Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi,në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore,në përputhje me legjislacionin shqiptarë...» Për këtë arsye skualifikoheni*

*Z. H Lamaj me kontratë pune Murator me pagë 30,000 leke nga verifikime ne listë pagesa paguhet me pagë 1,181 leke për periudhën Nentor 2018 – Prill 2019. PAGESA E SIGURIMEVE SHOQËRORE NUK ËSHTË BËRË MBI VLERËN 30,000, POR MBI VLERËN 1,181 leke. Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë pagë duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643,datë20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 «Kriteret e perjashtimit te kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet «Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptarë...» Për këtë arsye skualifikoheni.*

*Z.K Bukaci me kontratë pune Murator me pagë 30,000 leke nga verifikime ne listë pagesa paguhet me pagë 1,181 leke për periudhën Nentor 2018 – Prill 2019. PAGESA E SIGURIMEVE SHOQËRORE NUK ËSHTË BËRË MBI VLERËN 30,000, POR MBI VLERËN 1,181 leke. Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë pagë duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore.*

*- Nga verifikimet e liste pagesave periudha Tetore 2018- Prill 2019, konstatohet se te gjithë, specialist ndertimi, karpentier, hekurkthyes, hidraulik, saldator, mekanik, elektrikist,manovrator.*

*- Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643,datë20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 « Kriteret e perjashtimit te kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet «Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar...» Për këtë arsye skualifikoheni Veprime keto ne kundërshtim me VKM Nr.42,date 16.01.2008 « Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari «i ndyshuar Kreu IV pika 2 e tij «Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit...Për këtë arsye skualifikoheni.*

II.3. Në datën 25.06.2019 operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit si vijon:

*“Shoqëria jonë është skualifikuar me pretendimin se:*

“Në DST është kërkuar dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Per kete duhet qe numri mesatar i punonjësve të siguruar të jetë jo më pak se 80 punonjës për periudhën Tetor 2018 – Prill 2019, nga keta, te kete punonjes te kualifikuar me Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trupe çertifikuese e akredituar ne RSH-se, nder te cilet te kete minimalisht 30 specialista ndertimi, 4 karpentier, 4 hekurkthyes e saldator, 1 hidraulik, 1 elektrikist, 1 mekanik, ku sejcili duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per gjashte muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave.

Në dokumentat e paraqitur ju nuk vertetoni nr për 30 specialista ndertimi, 4 karpentier, 4 hekurkthyes e saldator, 1 hidraulik, 1 elektrikist, 1 mekanik,

Z.N Baçi i punesuar me kontrate pune date 28.12.2018 Ing Ndertimi prane Kevin Konstruktion shpk rezulton dhe ne kompani të tjera i punesuar si me poshte: Fizik REAN 95, me numër NIPT-i J61827043V, per periudhen Tetor 2018 – Prill 2019, kjo nga vertetimi i Drejtoris Rajonale Tatimore Tirane Nr. Nr. T01111816, date 29.5.2019 dhe N. Baçi PF shpk NIPT-i K91721004S, per periudhen tetor-prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Nr. T01111799, date 29.5.2019. Në kompanine BOLENA shpk NIPT-i J87416223M, per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111838, date 29.5.2019. TONI-SECURITY NIPT-i K94010201F per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111832, date 29.5.2019. EUROGJICISESECURITY, NIPT-i K31929010K per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111820, date 29.5.2019. INA, NIPT-i J61814009Ë, K31929010K per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111811, date 29.5.2019 vulosur ne menyre elektronike, nxjerre nga verifikimi elektronik i e-alabania.

Znj.A.Ciko i punesuar me kontrate pune date 28.12.2018 Ing Mekanik Impiante prane Kevin Konstruktion shpk rezulton dhe ne kompani tjera i punesuar si me poshte: TIRANA TEKNOLOGJI, me numër NIPT-i L61312065J, per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtoris Rajonale Tatimore Tirane Nr. Nr. T01111853, date 29.5.2019 - Veprime keto ne kundershkrim me VKM Nr.42, date 16.01.2008 « Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari «i ndyshuar Kreu IV pika 2 e tije «Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit..Për këtë arsye skualifikoheni.

I. Palushi me kontrate pune Manovrator për periudhën Dhjetor – Prill është paguar me pagë poshtë pagës minimale sipas Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë pagë duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 « Kriteret e perjashtimit te kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet « Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptarë..» Për këtë arsye skualifikoheni.

Z.A. Sakaj Manovrator, eshte i punesuar dhe ne kompanine Kevin Konstruktion shpk ne baze te kontrates 20.02.2018 me page 30,000 leke ne muaj sipas verifikimeve ne sistemin oline e-albania paguhet per periudhen Mars-Prill 2019 me pagese 1,181 leke ne kundërshtim me kontraten e punes, nga verifikimi ne, ne baze te vertetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01118287 date 31.5.2019. Pagesa e sigurimeve shoqërore nuk është bërë mbi vlerën 30,000, por mbi vlerën 1,181 leke. Gjithashtu punonjësi duhej te ishte per nje periudhë 6-mujore i punësuar pranë Kevin Konstruktion shpk. Gjithashtu punonjësi për të njëjtën periudhë kohe është i punësuar dhe në kompani tjetër Fizik SPIECAPAG Transadriatica, me numer NIPT-i L61920026B , me perfaqesues ligjor Z/Znj. Guillaume, Marcel, Denis Batut sipas vertetimit e-albania Nr. Nr. T01118296 Drejtoria Rajonale DMT 31.5.2019.

Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë page duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 «Kriteret e perjashtimit te kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet «Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptarë...» Për këtë arsye skualifikoheni

Z. H Lamaj me kontratë pune Murator me pagë 30,000 leke nga verifikime ne listë pagesa paguhet me pagë 1,181 leke për periudhën Nentor 2018 – Prill 2019. Pagesa e sigurimeve shoqërore nuk është bërë mbi vlerën 30,000, por mbi vlerën 1,181 leke. Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë pagë duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 «Kriteret e perjashtimit te kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet «Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptarë...» Për këtë arsye skualifikoheni.

Z.K Bukaci me kontratë pune Murator me pagë 30,000 leke nga verifikime ne listë pagesa paguhet me pagë 1,181 leke për periudhën Nentor 2018 – Prill 2019. Pagesa e sigurimeve shoqërore nuk është bërë mbi vlerën 30,000, por mbi vlerën 1,181 leke. Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë pagë duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore.

- Nga verifikimet e liste pagesave periudha Tetore 2018- Prill 2019, konstatohet se te gjithe, specialist ndertimi, karpentier, hekurkthyes, hidraulik, saldator, mekanik, elektrikist, manovrator.

- Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 «Kriteret e perjashtimit te kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet «Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptarë...» Për këtë arsye skualifikoheni Veprime keto ne kundërshtim me VKM Nr.42, date 16.01.2008 «Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari «i ndyshuar Kreu IV pika 2 e tij «Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri

ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit...Për këtë arsye skualifikoheni.”

1. Kundërshtojmë arsyen e parë të skualifikimit se: - z.N. Baçi i punësuar me kontrate pune date 28.12.2018 Ing Ndertimi prane Kevin Konstruktion shpk rezulton dhe ne kompani tjera i punësuar si me poshte: Fizik REAN 95, me numër NIPT-i J61827043V, per periudhen Tetor 2018 – Prill 2019, kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. Nr. T01111816, date 29.5.2019, dhe N. Baçi PF shpk NIPT-i K91721004S, per periudhen tetor-prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Nr. T01111799, date 29.5.2019. Në kompanine BOLENA shpk NIPT-i J87416223M, per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111838, date 29.5.2019 .TONI-SECURITY NIPT-i K94010201F per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111832, date 29.5.2019. EUROGJICISESECURITY, NIPT-i K31929010K per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111820, date 29.5.2019. INA, NIPT-i J61814009Ë, K31929010K per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01111811, date 29.5.2019 vulosur ne menyre elektronike, ënxjerre nga verifikimi elektronik i e-alabania.

1.1. Në lidhje me këtë arsye skualifikimi bëjmë me dije se inxhinieri N.Baci si inxhinier ose ekspert zjarrfikës ka të drejtë të punojë në 1001 firma të tjera qofshin këto ndërtimi, qofshin karburantesh, përsa kohë nuk është i angazhuar si drejtues teknik pranë shoqërisë sonë. Nuk ka asnjë pengesë ligjore si dhe në dokumentat e tenderit që të ndalojë një inxhinier jodrejtues të jetë i siguruar me kohë të pjesshme apo të plotë pranë disa shoqërive të tjera përsa kohë referuar kontratës së punë, ky i fundit është angazhuar me kohë të plotë prej orës 08:00 deri në 16:00 pranë shoqërisë sonë. Nuk kuptohet absurditeti dhe keqdashja e autoritetit kontraktor për të paraqitur si arsye skualifikimi një absurditet të tillë. Inxhinier N.Baci është i kontraktuar me kohë të plotë pranë shoqërisë sonë dhe referuar kësaj kontrate ky punonjës ndodhet cdo ditë prej orës 08:00 deri në 16:00 në zyrat e shoqërisë sonë ose në kantieret e ndërtimit që janë në proces. Përsa më sipër pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron.

2. Në lidhje me arsyen e skualifikimit se: “- Znj.A. Ciko i punësuar me kontrate pune date 28.12.2018 Ing Mekanik Impainate prane Kevin Konstruktion shpk rezulton dhe ne kompani tjera i punësuar si me poshte: TIRANA TEKNOLOGJI, me numër NIPT-i L61312065J, per periudhen Tetor 2018 - Prill 2019, Kjo nga vertetimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane Nr. Nr. T01111853, date 29.5.2019 - Veprime keto ne kundershtim me VKM Nr.42, date 16.01.2008 « Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari «i ndyshuar Kreu IV pika 2 e tij «Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit...Për këtë arsye skualifikoheni.”

2.1 Në lidhje me këtë arsye skualifikimi shoqëria jonë sqaron se znj. A Ciko është e punësuar me kohë të plotë pranë shoqërisë “Kevin Konstruktion” sh.p.k si drejtuese teknike, duke u pasqyruar kështu edhe në licencën e shoqërisë. Në lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor se drejtuesja teknike është e dypunësuar ku rezulton që vec shoqërisë “Kevin Konstruktion” sh.p.k është punësuar pranë një kompanie

tjetër me kohë të plotë “Tirana Teknologji” sh.p.k, bëjmë me dije se: Znj. A.Ciko është e punësuar pranë shoqërisë sonë me kohë të plotë dhe referuar kontratës së punës dhe faktit se kjo inxhinierë ndodhet me kohë të plotë në zyrat e shoqërisë sonë ose në kantieret e ndërtimit prej orës 08:00 deri në 16:00 cdo dite. Shoqëria jonë në kushtet kur dypunësimi nuk lejohet për inxhinierët drejtues teknik të shoqërive të ndërtimit, u interesua pranë shoqërisë “Tirana Teknologji” sh.p.k në lidhje me faktin nëse znj. A.Ciko është e siguruar pranë kësaj shoqërie për periudhën tetor 2018- prill 2019. Në lidhje me këtë kërkesë tonën shoqëria “Tirana Teknologji” sh.p.k lëshoi një vërtetim ku vërtetonte se znj. A.Ciko nuk ka qënë e punësuar pranë shoqërisë “Tirana Teknologji” sh.p.k për periudhën tetor 2018- prill 2019.

Sa më sipër, pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron.

3. Në lidhje me arsyen e skualifikimit se: “I Palushi me kontrate pune Manovrator për periudhën Dhjetor – Prill është paguar me pagë poshtë pagës minimale. Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë pagë duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 «Kriteret e perjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet «Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar..» Për këtë arsye skualifikoheni.

3.1. Në lidhje me këtë arsye skualifikimi bëjmë me dije se marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës është një marrëdhënie individuale e cila mbrohet prej normave ligjore përkatëse dhe institucionet përkatëse të ngarkuara me ligj. Autoriteti kontraktor Bashkia Tropojë nuk ka asnjë kompetencë ligjore të bëjë vlerësime të përputhshmërisë me ligjin të kontratave të punës punëmarrës-punëdhënës përsa kohë institucionet kompetente të ngarkuara me ligj i kanë miratuar dhe s’i kanë kontestuar si joligjore këto të fundit. Sqarojmë këtu se vlera në listpagesa i del në përputhje me ditët e punës që ky punëmarrës ka patur gjatë periudhës së kërkuar. Kjo arsye skualifikimi, përpos antiligjore është dhe absurde. AK-ja shprehet se punonjësi është paguar nën pagën minimale dhe se veprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 45 “Kriteret e perjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2 gërma “d” ku thuhet: “Cdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.”

Shoqëria jonë në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur vërtetim se ka paguar të gjitha detyrimet mbi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron.

4. - Z.A. Sakaj Manovrator, është i punësuar dhe në kompaninë Kevin Konstruktion shpk në baze të kontratës 20.02.2018 me page 30,000 leke në muaj sipas verifikimeve në sistemin online e-albania paguhet për periudhën Mars-Prill 2019 me pagese 1,181 leke në kundërshtim me kontratën e punës, nga verifikimi, në baze të vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane Nr. T01118287 date 31.5.2019. Pagesa e sigurimeve shoqërore nuk është bërë mbi vlerën 30,000, por mbi vlerën 1,181 leke. Gjithashtu punonjësi duhej të ishte për një periudhë 6-mujore i punësuar pranë Kevin Konstruktion shpk. Gjithashtu punonjësi për të njëjtën periudhë kohe është i punësuar dhe në kompani tjetër Fizik SPIECAPAG Transadriatica, me numer NIPT-i L61920026B, me perfaqesues ligjor Z/Znj. Guillaume, Marcel, Denis Batut sipas vërtetimit e-albania Nr. Nr. T01118296 Drejtoria Rajonale DMT 31.5.2019.



*Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë page duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 «Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet «Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar...» Për këtë arsye skualifikoheni.*

*4.1. Në lidhje me këtë arsye skualifikimi bëjmë me dije se marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës është një marrëdhënie individuale e cila mbrohet prej normave ligjore përkatëse dhe institucionet përkatëse të ngarkuara me ligj. Autoriteti kontraktor Bashkia Tropojë nuk ka asnjë kompetencë ligjore të bëjë vlerësime të përputhshmërisë me ligjin të kontratave të punës punëmarrës-punëdhënës përsa kohë institucionet kompetente të ngarkuara me ligj i kanë miratuar dhe s'i kanë kontestuar si joligjore këto të fundit. Kjo arsye skualifikimi, përpos antiligjore është dhe absurde. AK-ja shprehet se punonjësi është paguar nën pagën minimale dhe se veprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2 gërma “d” ku thuhet: “Cdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.”*

*Shoqëria jonë në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur vërtetim se ka paguar të gjitha detyrimet mbi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron.*

*Në lidhje me pjesën se ky punonjës është i punësuar dhe në një shoqëri tjetër bëjmë me dije se punonjësi A.Sakaj referuar kontratës së punës është në dispozicion të shoqërisë sonë përsa kohë qëndron i kontraktuar.*

*Në lidhje me pretendimin se gjithashtu punonjësi duhet të ishte për një periudhë 6-mujore i punësuar pranë Kevin Konstruksion shpk bëjmë me dije se në kriteret kualifikuese, autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar periudhën për të cilën kërkohet që punonjësi A.Sakaj të jetë i punësuar. Konkretisht në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të ketë 5 manovratorë me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik e lëshuar nga një trupe certifikuese e akredituar në RSH, sipas makinerive që do të drejtojnë.*

*Përsa më sipër është e qartë se autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një periudhë të caktuar të cilën operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar punonjës të manovrator.*

*Ndodhur në këto kushte pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron.*

*5. z. H. Lamaj me kontratë pune Murator me pagë 30,000 leke nga verifikime në listë pagesa paguhet me pagë 1,181 leke për periudhën Nentor 2018 – Prill 2019. Pagesa e sigurimeve shoqërore nuk është bërë mbi vlerën 30,000, por mbi vlerën 1,181 leke. Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë pagë duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 «Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet «Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar...» Për këtë arsye skualifikoheni.*

5.1. Në lidhje me këtë arsye skualifikimi bëjmë me dije se marrëdhënia punëdhënës- punëmarrës është një marrëdhënie individuale e cila mbrohet prej normave ligjore përkatëse dhe institucionet përkatëse të ngarkuara me ligj. Autoriteti kontraktor Bashkia Tropojë nuk ka asnjë kompetencë ligjore të bëjë vlerësime të përputhshmërisë me ligjin të kontratave të punës punëmarrës-punëdhënës përsa kohë institucionet kompetente të ngarkuara me ligj i kanë miratuar dhe si kanë kontestuar si joligjore këto të fundit. Kjo arsye skualifikimi, përpos antiligjore është dhe absurde. AK-ja shprehet se punonjësi është paguar nën pagën minimale dhe se veprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2, gërma “d” ku thuhet: “Cdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.”

Shoqëria jonë në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur vërtetim se ka paguar të gjitha detyrimet mbi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron.

6. Z.K. Bukaci me kontratë pune Murator me pagë 30,000 leke nga verifikime ne listë pagesa paguhet me pagë 1,181 leke për periudhën Nentor 2018 – Prill 2019. Pagesa e sigurimeve shoërore nuk është bërë mbi vlerën 30,000, por mbi vlerën 1,181 leke. Punonjësi i mësipërm duhet të deklarohej në sigurime me pagën e vendosur në kontratën e punës dhe po mbi këtë pagë duhej të paguheshin edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore.

- Nga verifikimet e liste pagesave periudha Tetore 2018- Prill 2019, konstatohet se te gjithë, specialist ndertimi, karpentier, hekurkthyes, hidraulik, saldator, mekanik, elektrikist, manovrator.

- Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9643, datë 20.11.2006 «Për prokurim publik» i ndryshuar, nenin 45 «Kriteret e perjashtimit te kandidatëve ose ofertuesve», pika 2 gërma d, ku thuhet «Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar...». Për këtë arsye skualifikoheni.

6.1. Në lidhje me këtë arsye skualifikimi bëjmë me dije se marrëdhënia punëdhënës- punëmarrës është një marrëdhënie individuale e cila mbrohet prej normave ligjore përkatëse dhe institucionet përkatëse të ngarkuara me ligj. Autoriteti kontraktor Bashkia Tropojë nuk ka asnjë kompetencë ligjore të bëjë vlerësime të përputhshmërisë me ligjin të kontratave të punës punëmarrës-punëdhënës përsa kohë institucionet kompetente të ngarkuara me ligj i kanë miratuar dhe s'i kanë kontestuar si joligjore këto të fundit. Kjo arsye skualifikimi, përpos antiligjore është dhe absurde. AK-ja shprehet se punonjësi është paguar nën pagën minimale dhe se veprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 45 “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve”, pika 2 gërma “d” ku thuhet: “Cdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.”

Shoqëria jonë në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur vërtetim se ka paguar të gjitha detyrimet mbi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron.”

II.4. Njëpërmjet shkresës Nr.1900/1 Prot., datë 27.06.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

II.5. Në datën 05.07.2019 operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 15.07.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1207/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1900/3 prot., datë 11.07.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k se: “Në DST është kërkuar dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

*Per kete duhet qe numri mesatar i punonjësve të siguruar të jetë jo më pak se 80 punonjës për periudhën Tetor 2018 – Prill 2019, nga keta, te kete punonjes te kualifikuar me Dëshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trupe çertifikuese e akredituar ne RSH-se, nder te cilet te kete minimalisht 30 specialista ndertimi, 4 karpentier, 4 hekurkthyes e saldator, 1 hidraulik, 1 elektrikist, 1 mekanik, ku sejcili duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per gjashte muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave.*

*Në dokumentat e paraqitur ju nuk vertetoni nr për 30 specialista ndertimi, 4 karpentier, 4 hekurkthyes e saldator, 1 hidraulik, 1 elektrikist, 1 mekanik,*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 12, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 3, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës së mëposhtme:

*Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Per kete duhet qe numri mesatar i punonjësve të siguruar të jetë jo më pak se 80, punonjës për periudhën Tetor 2018 - Prill 2019, nga keta, te kete punonjes te kualifikuar me Dëshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trupe çertifikuese e akredituar ne RSH-se, nder te cilet te kete minimalisht 30 specialista ndertimi, 4 karpentier, 4 hekurkthyes e saldator, 1 hidraulik, 1 elektrikist, 1 mekanik, ku sejcili duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per gjashte muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave*

*Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- *Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar më sipër.*

- *Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për të gjithë periudhën e kërkuar më sipër.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit, si dhe nga shqyrtimi i ankesave të paraqitura nga operatori ekonomik ankimes respektivisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se nga ana e tij nuk është kundërshtuar arsyeja e mësipërme e skualifikimit sikurse është cituar në pikën III.1 të arsyetimit.

III.1.3. Duke mbajtur në konsideratë faktin që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i ankesës i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimes pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimesit, një prej arsyeve të skualifikimit nuk është ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në Komisionin e Prokurimit Publik.

III.1.4. Në nenin 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 , 5, 6 dhe 7 parashikohet se:

*“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji” (pika 2).*

*“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës (pika 5).”*

*“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor” (pika 6).*

*“Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkëljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me LPP, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme” (pika 7).*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k, nuk janë ndjekur shkallët e ankimit lidhur me arsyen e skualifikimit: “Në dokumentat e paraqitur ju nuk vertetoni nr për 30 specialistë ndertimi, 4 karpentier, 4 hekurkthyes e saldator, 1 hidraulik, 1 elektrikist, 1 mekanik”.

Në këto kushte, duke qënë se aktualisht kanë përfunduar afatet e ankimimit në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, rrjedhimisht arsyet e skualifikimit të cilat nuk janë ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në KPP, nuk mund të merren në shqyrtim nga ky komision e për rrjedhim ai rezulton të ngelet i skualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Edhe në hipotezën se pretendimet e tjera të paraqitura pranë autoritetit kontraktor e më pas në KPP do të qëndronin, operatori ekonomik ankimes nuk do të ndryshonte gjendjen e tij faktike e juridike, por do të mbetej sërish i skualifikuar nga procedura në fjalë, për shkaqet e skualifikimit të bëra më dije në datën 18.06.2018, të cilat nuk janë ankimuar pranë autoritetit kontraktor e më pas në KPP, në respekt të shkallëve të ankimimit.

Përsa më sipër, ankesa e operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k, përsa i përket skualifikimit të tij, nuk do të merret në shqyrtim.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-18885-04-18-2019, me objekt: “*Shkolla Asim Vokshi-Palester dhe terrene sportive dhe sisteme te jashtme ne gjimnazin "Asim Vokshi"*”, me fond limit 50 319 591 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 24.05.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Tropojë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1207 Protokolli,**

**Datë 05.07.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**